



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

Nr. 5282/Prot.

Pogradec, më 19. 11. 2021

VENDIM

Nr. 96 datë 18. 11. 2021

"PER MIRATIMIN E KËRKESËS FAMILJES SË Z.AVNI HAMZALLARI QË DO TË VAZHDOJË PROCEDURËN E PRIVATIZIMIT TË BANESËS SHTETËRORE QË KA MBETUR PAPRIVATIZUAR"

Mbështetur në Ligjin Nr.22/2018 "Për Strehimin Social", gjithashtu dhe në zbatim të VKM Nr.179, datë 26.02.2020 "Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qënë subjekt i ligjit Nr.7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", dhe të Ligjit Nr.9321, datë 25.11.2004, "Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyera në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe të ndërrmarjeve shtetërore", dispozitat e të cilit përcaktojnë procedurën e privatizimit të banesave që kanë mbetur të paprivatizuara, dhe VKM NR.898 , datë 18.11.2020 "RREGULLAT , KUSHTET , KRITERET E PROCEDURAT E PRIVATIZIMIT TË BANESAVE DHE OBJEKTEVE TË KTHYERA NË FOND BANESE TË PAPRIVATIZUARA", me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së familjes së mëposhtme për vazhdimin e procedurës së privatizimit të banesave që kanë mbetur të paprivatizuara.

Emri Mbiemri	Adresa	Dokumentacioni për plotësim	Procedura e privatizimit
Avni Hamzallari (Tatjana Hamzallari)	Rr."Rinia" Nd.13 , H.4 , Ap.18	Formular 1 ,2 ,3 Kontratë Shit-Blerje	Pagesa është kryer, Nënshkrim Kontrate

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Strehimit.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike.

KRYETAR

Sotiraq MANGËRI

